

PRE në kohën e pandemisë së Koronës dhe rimëkëmbja ekonomike

Mojmir Mrak, Janez Šušteršič
Ekspertë bashkëpunëtorë të CEF

Maj 2020



Financuar nga Bashkimi
Evropian

Hyrje

- Kriza aktuale ekonomike e shkaktuar nga **Pandemia e COVID 19 do të ketë implikime të thella në ekonominë e rajonit** dhe, rrjedhimisht, edicioni i PRE-ve i vitit të ardhshëm thjesht nuk mund të bëhet me qasjen e “punës së zakonshme”.
- **Prioritetet e qeverive do të jenë** zbutja e pasojave negative të krizës së COVID 19 dhe **mbështetja e rimëkëmbjes së shpejtë ekonomike**, dhe do të përcaktohen si prioritet mbi reformat e orientuara strukturore afatmesme.
- Këto realitete **duhet të pasqyrohen në dokumentin Udhëzues të PRE 2021-2023**, nëse PRE-të synojnë të mbeten relevante brenda vetë vendeve candidate.
- Ky prezantim është i **bazuar në një dokument të Ekspertëve të CEF** dërguar Komisionit të BE-së për tu marrë parasysh gjatë përgatitjes së Udhëzuesit të ardhshëm të PRE.
- Qëllimi i këtij prezantimi është **që të mbledh informata** nga propozimet e **palëve të interesit të PRE-së në rajon**



Një kontekst i shkurtër ekonomik dhe politik



Si dallon kriza ekonomike e COVID 19 nga kriza financiare e vitit 2008?

- **E shkaktuar nga faktorë jo-ekonomikë:** nga pandemia dhe nga masat e mbylljes (ndalesës) nga qeveritë për të zbutur përhapjen e virusit.
- **E prek tërë ekonominë në të njëjtën kohë:** të gjithë sektorët e ekonomisë të prekur, si ana e ofertës ashtu edhe ajo e kërkesës (ndërprerje e prodhimit, ulje e të ardhurave të familjeve dhe e konsumit).
- **Qeveritë** reagues më shpejt dhe më me vendosmëri, por ato u **përballen me një kompromis [që duhej bërë] ndërmjet objektivave shëndetësore dhe objektivave ekonomike.**
- Rënia e BPV-së është e ngjashme me 2008-19, por **rimëkëmbja pritet të jetë më e shpejtë** (rritje e lartë pozitive parashikohet për 2021).
- Një rimëkëmbje e shpejtë është **më pak e mundshme në vendet me mosbalancë strukturore ekzistuese dhe me konkurrueshmëri të dobët.**

Masat ekonomike për të adresuar krizën

Masat e përkohshme “të mbijetesës” (deri në 3 muaj)

- Synojnë të mbështesin sektorin e shëndetësisë, bizneset dhe popullsinë gjatë shpërthimit të virusit dhe bllokimit (mbylljes)
- Kostot jashtëzakonisht të larta buxhetore
- Do të **ndikojë në perspektivën fiskale për PRE 2021-2024** dhe në fondet në dispozicion për reformat strukturore

Masat afatshkurtra të rimëkëmbjes (1-2 vjet)

- Synojnë të mbështesin rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike dhe përmirësimin e gjendjes sociale pas bllokimit
- Kostot e larta buxhetore
- Do të jetë prioriteti kryesor i qeverive - **a duhet të përfshihen ato në PRE 2021-2023 në vend të disa reformave strukturore më pak urgjente?**

Masat afatshkurtra dhe reformat e PREsë

Disa shembuj

Masat për të hyrat

- Shtyrjet tatimore, anulimet dhe uljet
- Ulja e tarifave për shërbimet publike, qiratë etj.
- Relevante për **Perspektivën e buxhetit** - një presion për të zvogëluar shpenzimet dhe **financimin e reformave të planifikuara strukturore**

Masat e likuiditetit

- Moratorium për rikthimin e kredive, garancitë e kredive
- Rritja e **detyrimeve kontingjente** - Kapitulli Fiskal i PRE-së
- Mund të kombinohet me **reformat ekzistuese për Qasje në Financa**

Masat e mbijetesës së biznesit

- Subvencione për të parandaluar falimentimet për shkak të krizës
- Të kushtueshme; **mund të merr mjetet nga reformat strukturore tashmë të planifikuara** (reformat sektoriale, mjedisi i biznesit, RDI etj)



Masat e ristrukturimit të biznesit

- Mbështetje për rifillimin dhe përmirësimin e veprimtarisë së tyre - për sektorë specifikë, grupe (NVM, eksportues) ose aktivitete (RDI)
- Janë të mundshme **sinergjitë** me reformat strukturore tashmë të planifikuara - **por reformat ekzistuese duhet të përshtaten**

Masat e ruajtjes së punësimit

- Subvencione për kohë më të shkurtër të punës, kohën jashtë punës; subvencione për paga
- Të kushtueshme; **mund të merr mjetet nga reformat strukturore tashmë të planifikuara në tregun e punës**

Masat e mbështetjes së të ardhurave

- U drejtohet pjesëve më të prekura të popullatës nga kriza
- Vështirë për tu zbatuar me sisteme joefikase të mbrojtjes sociale dhe mbulueshmëri të dobët - **duke rritur nevojën për reforma në sigurinë sociale**

**Si ta pasqyroni këtë kontekst në Udhëzuesin
dhe përgatitjen e PRE-së?**



Udhëzuesi i PRE - në përgjithësi

- **"Reforma" ekonomike > Programi i "rimëkëmbjes"**: Vendet do t'i përgjigjen krizës me masa që kryesisht kanë për qëllim rivendosjen e rimëkëmbjes ekonomike, me prioritet ndaj reformave afatmesme
- **Kapitulli hyrës i "krizës COVID 19"**: (i) filozofia e përgjithshme e reagimit me politika, (ii) reagimi i deritanishëm, (iii) reagimet e planifikuara në të ardhmen, (iv) krijimi i hapësirës fiskale për të financuar masat reaguese, (v) përcjellja e karakterit "të përkohshëm" të reagimit në buxhete
- Kapitulli makro: shpjegimi i hollësishëm i **implikimeve makroekonomike të COVID 19** në secilin nën-kapitull
- Kapitulli fiskal: nën-kapitulli i veçantë për **prezantim të hollësishëm dhe analizë të implikimeve fiskale të COVID 19** sa i përket kohës së hartimit, përfshirë edhe mënyrën se si ato kanë ndikuar në financimin e reformave strukturore

Udhëzuesi i PRE-së - Kapitulli i RS

- Fokusimi i ri-përcaktuar në RS dhe masat që synojnë (i) **rimëkëmbje të shpejtë ekonomike**, dhe (ii) **adresim të efekteve sociale të krizës**
- Pengesat: të ri-përcaktuara në përputhje me fokusin e kapitullit. **Shpjegoni se si janë prekur resurset njerëzore dhe financiare për zbatimin e RS në vitin 2020-21**
- **RS e ri-prioritizuar dhe fokusuar** në plotësimet e mundshme (sinergjitë) me masat afatshkurtra të rimëkëmbjes ekonomike
 - **Rishqyrtoni dhe ri-planifikoni reformat ekzistuese** për të mbështetur rimëkëmbjen ekonomike në afat të shkurtër dhe për të arritur ndryshimin strukturor në periudhën afatmesme
 - **Shtyni reformat ekzistuese që nuk mund të ri-planifikohen** për një përditësim të mëvonshëm të PRE-së, mos i shtyni për PRE 2021-23
 - **Prezantoni masa afatshkurtra për të shpejtuar rimëkëmbjen ekonomike ose për të lehtësuar pasojat sociale të krizës** në vend të reformave të shtyra, edhe nëse nuk është 'reformë strukturore'
- 15-20 masa prioritare por të shpërndara ndërmjet masave "**të reja**" që synojnë **rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike - të artikuluar kryesisht nga vendet - dhe RS-ve "tradicionale"**



Udhëzuesi i Kostimit i CEF-së

- **Implikimet e COVID 19** (shih kapitullin 5): (1) financimi i zvogëluar ose RS-të e shtyra, (2) fondet e rialokuara drejt stimulimit ekonomik
- **Metodologjia ekzistuese e kostimit mbetet e zbatueshme si për masat “e reja” ashtu edhe për ato “tradicionale”**
- **Rritja e pasigurisë dhe rrezikshmërisë së kostove dhe financimit në dispozicion** paraqet sfidën kryesore për kostimin e reformave në PRE-të e ardhshme:
 - vlerësoni me kujdes **rreziqet e zbatimit + rreziqet për disponueshmërinë e fondeve** → në mënyrë rigoroze përfshini vetëm fondet e siguruara në mënyrë të qartë, shmangni përdorimin e 'të përcaktohen'
 - zhvilloni **skenarin e kontingjencës** për reformat që kërkojnë financim të konsiderueshëm/ aktivitetet e prioritizuara kur financimi është i pamjaftueshëm
 - Eksploroni në mënyrë aktive **'hapësirën e manovrimit'** për të siguruar fonde shtesë për masat prioritare, ri-alokoni brenda buxhetit, ndërroni qëllimin e mbështetjes së donatorëve
 - planifikimi më realist i lehtësuar shumë nga **përafrimi më i madh i PRE-së dhe kalendarëve të përgatitjes dhe miratimit të buxhetit**
 - duhet të jeni **të hapur dhe e gatshëm për paqartësitë** në vlerësimet e kostos.



Komentet dhe sugjerimet tuaja?

